

Të dashur prindër,

Shkolla ku fëmija i juaj është i lajmëruar, dëshiron t'ju ofrojë-tju huazoje një pajisje elektronike të lëvizshme (tabletë). Kjo i jep fëmijës tuaj mundësinë për të mësuar për shkollën, si dhe për të marrë pjesë në orët e mësimit nga shtëpia (mesim-onlein). Sepse, siç e dini, zhvillimi i mësimit “shkollimit nga shtëpia” po bëhet gjithnjë e më aktuale për shkaqe të ndryshme .

Nëse, juve ju takon kjo mbështetje,(përkrahje) për një tabletë, këtë do ta verifikojë e vendosë drejtoria e shkollës në bashkëpunim me seksionin e arsimit të qytetit Rhede.

Ju lutemi, lidhur me këtë përgjigjuni pyetjeve në formularin e aplikimit p.sh. pyetjet si më poshtë :

- a keni ju një lidhje interneti në shtëpi
- a keni ju tashmë një pajisje elektronike kumonikimi si (Leptop, PC, tablet,) ; dhe
- a keni ju të drejtë për përfitim, mbështetje për pjesëmarrje në arsimim .
(Nëse keni të drejtë për përfitime për arsimim dhe pjesëmarrje, zakonisht ju jeni të pajisur me një dokument /kartë të quajtur Musterlandkarte për fëmijën tuaj.)

Në fund, ju duhet të nënshkruani:

- Që ju i keni dhënë të gjitha informatat,apo të dhënat e sakta,të kërkuara me vërtetësi
- Që ky tablet (pajisjen elektronike) do të përdoret vetëm dhe vetëm për qëllime shkollore dhe nuk do të lejohet të kalojë te njerëzit e tjerë
- Ju jeni të qartësuar, të vetëdijsëm që tableta është vetëm një pajisje huazimi dhe se në çdo kohë kur t`ju këkohet, duhet ta ktheni atë në shkollë (pra është pronë e shkollës)

Pjesën e fundit të kontratës/të formularit, nuk duhet ta plotësoni ju, ajo plotësohet nga shkolla.

Nëse ju, keni vështirësi në plotësimin e kontratës/aplikimit/ kërkesës, ju lutemi të kontaktoni mësuesin e klasës ose punonjësin social në shkollë. Ata me siguri do t'ju ndihmojnë juve më shumë kënaqësi,për cdo pyetje ose paqartësi që mund të keni.